



FUSHATA PËR TË
DREJTAT E PUNËS

Punë e Denjë për Jetë të Dinjitetshme



MAJI

DITA NDËRKOMBËTARE E PUNËTORËVE

Përkrahur nga:



Partnerët zbatues:





E gjithë bota e di që unë jam i pafajshëm. Nëse më varin, do të varem jo se jam vrasës, por sepse jam punëtor.

-Albert Parsons, 1886-

NJË MAJI, DITA NDËRKOMBËTARE E PUNËTORËVE

Një Maji - Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve është një ditë në të cilën punëtorët festojnë, respektivisht përkujtojnë luftën e tyre për kushte më të mira pune, për shkurtimin e orarit të punës në tetë orë dhe një pagë të garantuar për jetesë. Kjo ditë që njihet me emrin Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve apo edhe Dita e Punës, në shumë vende të botës festohet me 1 maj, përdërisa në disa shtete të Amerikës Veriore, në të hënën e parë, të muajit shtator¹. Kjo ditë ndërkombëtare e punëtorëve, paraqet festën më të përhapur në rruzullin tokësor².

Festa e 1 Majit është dita e rikujtimit të rezistencës së punëtorëve që kanë bërë kundër shfrytëzimit dhe keqtrajtimit nga punëdhënësit e tyre. Këto rezistenca kanë një histori që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, pas revolucionit industrial dhe lindjes së kapitalizmit.

Revolucioni industrial me të vërtetë solli shumë lehtësime në jetën e njerëzimit, por në anën tjetër krijoi struktura të theksuara shoqërore, të cilat përbëhen nga klasa e lartë, e mesme dhe ajo punëtore. Klasa punëtore lindi meqë ekonomisë agrare i kishte ardhur dalëngadalë fundi dhe njëkohësisht kishin filluar zhvillime të reja ekonomike në industri³. Në fabrikat dhe minierat të cilat kontrolloheshin dhe në të vërtetë ishin pronësuar ngëa shtresa e lartë apo borgjezia, kushtet e punës për klasën punëtore ishin të mjerueshme. Gjatë viteve 1830-1840, punëtorët punonin rreth 12-16 orë në ditë, 6 ditë në javë, pra gjithsej 84 orë në javë⁴. Në mesin e punëtorëve në fabrika kishte gra, fëmijë nga mosha 5 vjeçare, që detyroheshin të punonin, me paga shumë të ulëta. Gjithashtu, gratë shtatëzëna nuk kishin të drejt për pushim⁵.

**GJATË VITEVE
1830-1840**
PUNËTORËT PUNONIN
12-16
ORË NË DITË
84 ORË NË JAVË

Siguria në punë ishte shumë e ultë, shumë puntorë pësonin lëndime të rënda trupore, apo edhe e humbnin jetën e tyre. Dhuna në punë ishte e përhapur tepër, puntorët në gabimin më të vogël ndëshkoheshin me pagë të ultë apo me përjashtim nga vendi i punës.

Manifesti Komunist, i Karl Marksit dhe Frederik Engelsit, bëri që brenda punëtorëve të krijohet një vetëdije kolektive për të drejtat e tyre, e poashtu të lind ideja e sindikalizimit, ku mbretëronte sllogani “Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni”⁶.

¹ <https://news.jagatgururampalji.org/international-labour-day/>

² https://archive.iww.org/history/library/misc/origins_of_mayday/

³ <https://library.fiveable.me/ap-world/unit-5/social-effects-industrialization/study-guide/yz9JKbQAG6X4xBMGJGWO>

⁴ https://www.youtube.com/watch?v=_6ZFUKENE0I

⁵ https://www.youtube.com/watch?v=_6ZFUKENE0I

⁶ <https://books.google.com/books?id=RIKaBQAAQBAJ&pg=PA471#v=onepage&q&f=false>

NJË MAJI, DITA NDËRKOMBËTARE E PUNËTORËVE

Ndonëse punëdhënësit në bashkëpunim me qeveritë e asaj kohe, i kundërshtuan dhe tentuan t'i shtypnin këto ide, kërkesa e punonjësve për të drejtat e tyre forcohej gjithnjë e më tepër.

Një ndër revoltat kryesore të punëtorëve dhe si nismëtare e protestave pasuese të 1 majit, ishte greva e gurëgdhendësve në qytetin e Melburnit të Australisë, më 21 prill 1856⁷. Në atë grevë, ata protestuesuan për kushtet e vështira dhe për orarin e gjatë të punës, prej 10 orësh në ditë. Gurëgdhendësit kërkonin shkurtimin e orarit të punës në tetë orë, gjë që u bë slogani i grevës tetë orë punë, tetë orë pushim dhe tetë orë rekreacion. Pas kësaj greve, u miratua kërkesa për “3 tetshe”, gjegjësisht orari i punës u redukua në tetë orë⁸. Greva e gurgdhendësve të Melburnit ishte një fitore e madhe për klasën punëtore dhe një ngjarje inspiruese për të gjithë puntorët e vendeve të ndryshme të botës.

Në SHBA, Dita e Punëtorëve, për herë të parë është festuar më 5 shtator 1882, në qendër të qytetit të New York, në Union Square, ku pjesëmarrës ishin një numër i madh i puntorëve me familjet e tyre⁹. Kjo nuk ishte festë e organizuar nga shteti, por ishte vetëm një organizim i sindikatave në SHBA, për nderë të mundit dhe punës së punëtorëve. Gjatë kësaj dite punëtorët bënë organizim në formë të pikniqeve, paradave por njëherit edhe protestave për pagat e ulta dhe kushtet mjeruese në vende të punës¹⁰. Nga kjo ditë në të ardhmen u ndërlidh nevoja dhe dëshira e punëtorëve që të kenë një ditë në shenjë të tyre, ku ata do të mundeshin të protestonin për çështjet dhe padrejtësitë në vendet e tyre të punës, si dhe kundër eksploatimit të tyre. Përkundër kësaj, në SHBA, gjatë gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë eksploatimi i puntorëve, nga punëdhënësitë e tyre, ishte gjithnjë e më i madh. Njëkohësisht shumë organizata dhe sindikata si " Federata e Sindikatave të Organizuara dhe Punës "11 dhe " Kalorësit e Punës "12 mundoheshin sa më tepër të parandalonin dhe pengonin, shfrytëzimin e punëtorëve dhe të siguronin të drejtat e punëtorëve¹³.

Në tetor të vitit 1884, Federata e Tregtisë së Organizuar dhe Sindikatave të Punës të SHBA-ve, merr vendim se pas 2 vitesh, më 1 maj 1886, orari i punës duhet të reduktohet në 8 orë, si standard që do të vlenë për të gjithë punëtorët¹⁴. Pasiqë ky vendim i marr nuk është përfillur e as realizuar, me 1 maj të vitit 1986, në shumë qytete të SHBA-së u organizuan greva

⁷ <https://www.nma.gov.au/defining-moments/resources/eight-hour-day>

⁸ <https://www.facebook.com/watch/?v=1879057748961173>

⁹ <https://www.dol.gov/general/laborday/history>

¹⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=FJamea576YY&t=132s>

¹¹ Federation of Organized Trade Unions and Labor

¹² Knights of Labor

¹³ https://en.wikipedia.org/wiki/Federation_of_Organized_Trades_and_Labor_Unions, https://en.wikipedia.org/wiki/Knights_of_Labor

¹⁴ https://h2g2.com/edited_entry/A627662

NJË MAJI, DITA NDËRKOMBËTARE E PUNËTORËVE

masive, sidomos në Çikago ku numri i punëtorëve protestues kishte arritur deri në 30 - 40 mijë, ku këto protesta zgjatën katër ditë¹⁵.

Protestuesit u sulmuan nga banda të ndryshme, e të cilët ishin angazhuar nga punëdhënësit e punëtorëve dhe gjatë konfliktit mes bandave dhe punëtorëve, policia qëlloi me armë në disa punëtorë. Por, kjo nuk i ndaloi punëtorët nga protesta, përkundrazi punëtorët u organizuan edhe më tepër dhe protesta arriti kulmin në ditën e katërt gjegjësisht me 4 maj¹⁶.

Atë ditë, në qytetin e Çikagos, në qendrën Haymarket, tre sindikalist August Spikes, Albert Parsons dhe Samuel Fielden e mbajtën një fjalim, për shkeljen e të drejtave të punëtorëve dhe redukimin e orarit të punës në 8 orë¹⁷. Gjatë tërë kohës, protestuesit mbanin vetëm fjalime dhe ishin aq të qetë, saqë edhe kryetari i komunës së Çikagos, Carter Harrison dëgjonte fjalimet e tyre. Por, gjatë përfundimit të fjalimit të Samuel Fielden, forcat policore bënë ndërhyrje duke e urdhëruar që të mbarojë fjalimin. Në ato momente, një person i panjohur hodhi një bombë tek forcat policore, të cilët pastaj hapën zjarr tek protestuesit, ku katër protestues vdiqën në vend të ngjarjes dhe 70 u plagosën¹⁸. Si fajtorë të kësaj trazire u treguan tetë organizuesit e protestave dhe më gusht të vitit 1886 ata u gjykuan¹⁹. Gjatë gjykimit, ndonëse nuk ishte gjetur asnjë fakt se këta tetë organizatorë të protestës, e kishin organizuar edhe hudhjen e bombës, ata u treguan si fajtorë dhe si anarkistë. Gjatë seancës së gjykimit Albert Parsons i është ofruar marrëveshja se nëse kërkon falje, nuk do të denohet dhe do të lirohet. Ai nuk e pranoi këtë dhe u shpreh duke thënë se - “E gjithë bota e di që unë jam i pafajshëm. Nëse më varin, do të varem jo se jam vrasës, por sepse jam punëtor”²⁰. Pas gjykimit, katër organizatorë të protestave në mesin e tyre edhe Albert Parsons edhe August Spies, u dënuan me dënim me vdekje, të cilët u ekzekutuan më 17 nëntor 1887²¹. Në varrimin e protestuesve të ekzekutuar, morrën pjesë mijëra punëtorë të fabrikave dhe minierave²².

Në 1889, në kongresin e parë të Internacionales së Dytë, e cila ishte një organizatë e partive socialiste dhe punëtore, u propozua nga Raymond Lavigne, një sindikalist francez, që me 1 maj 1890 të bëhen demonstrata ndërkombëtare për përvjetorin e protestave në Çikago²³. Ky propozimi i Raymond Lavigne-it bëri jehonë të madhe dhe me 1 maj 1890 në shumë vende të botës u organizuan protesta, si në SHBA, në shumicën e shteteve Evropiane, në Kili dhe në Peru²³.

¹⁵ <https://www.nytimes.com/1886/05/05/archives/rioting-and-bloodshed-in-the-streets-of-chicago-police-mowed-down.html>

¹⁶ <https://www.youtube.com/watch?v=rJuN8PP6o54&t=222s>

¹⁷ https://en.wikipedia.org/wiki/Haymarket_affair#cite_note-47

¹⁸ https://en.wikipedia.org/wiki/Haymarket_affair#cite_note-47

¹⁹ <https://www.history.com/topics/19th-century/haymarket-riot>

²⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=rJuN8PP6o54&t=222s>

²¹ <http://law2.umkc.edu/faculty/projects/ftrials/haymarket/haymarketdefendants.html>

²² <https://www.youtube.com/watch?v=rJuN8PP6o54&t=>

²³ https://journals.co.za/doi/pdf/10.10520/AJA15955753_276

NJË MAJI, DITA NDËRKOMBËTARE E PUNËTORËVE

Në shtetet demokratike perëndimore tek pas shumë dekadave, punëtorët, përmes veprimit të sindikatave, kanë arritur të fitojnë të drejta pak më të mëdha, gjë që bëri që tensionet sociale të qetësohen, sidomos me kalimin e kohës.

Në anën tjetër, për shtetet socialiste, 1 Maji kishte një kuptim të veçantë dhe simbolik. Fillimisht, në shtetin e asaj kohe BRSS (Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike) pas revolucionit bolshevik, e pastaj edhe në shtetet tjera socialiste, të udhëhequra nga një qeverisje me ideologji marksiste-leniniste dhe njëpartiake, të cilat e kishin për model programin politik të BRSS-së, 1 maji u shpall festë zyrtare dhe ditë pushimi, që i atribuohet punëtorëve²⁴.

Në këtë ditë, punëtorët bartnin parulla politike dhe i zbukuronin fabrikat me simbolet e tyre. Në qendrat e qyteteve organizoheshin parada ushtarake, ku ushtarët parakalonin nëpër rrugët e qytetit duke marshuar, derisa qytetarët e përcjellnin me kënaqësi këtë spektakël. Pas përfundimit të paradës, presidenti dhe sekretari i përgjithshëm i Partisë Komuniste, mbanin fjalime të ndryshme për rëndësinë dhe kuptimin e kësaj dite.

Në ish-Jugosllavi, si shtet socialist njëpartiak, 1 Maji njihej si Dita e Punëtorëve. Si në vendet e tjera me regjime marksiste-leniniste, edhe Jugosllavia pati një formë të ngjashme të kremtimit të kësaj dite, me parada ushtarake në qendër të qytetit dhe pas paradës, zyrtarë të lartë të Partisë Komuniste mbanin fjalime për rëndësinë dhe nevojën e solidaritetit të punëtorëve, në Jugosllavi²⁵. Gjithashtu, organizoheshin manifestime të ndryshme kulturore, si koncerte, shfaqje teatrale dhe të filmave dokumentarë. Punonjësit gëzonin dy ditë pushimi, të cilat u shnëdërruan në një traditë që të dilet në pikniqe me familjarët, kolegët dhe miqtë e tyre, gjë që xhirohej dhe emitohej nëpërmjet televizionit shtetëror, si i vetmi që ishte në atë kohë²⁶.

Kjo traditë ishte e përhapur edhe në Kosovë, ku njerëzit mbledheshin për festuar të 1 Majin në vende të ndryshme pitoreske të Kosovës, sidomos në Parkun e Gërmisë²⁷. Kjo traditë e festimit vazhdon edhe në ditët e sotme.

Ndonëse në shtet me regjime njëpartiake dhe në vendet e pazhvilluara, organizoheshin të gjitha këto manifestime dhe lëvizja punëtore përkrahej, e tëra kjo, në të vërtetë ishte më tepër në mënyrë deklarative, derisa në realitet kjo drejtohej dhe kontrollohej, për mirëqenien e elitës burokratike²⁸.

²⁴ https://en.wikipedia.org/wiki/International_Workers%27_Day#cite_note-27

²⁵ <https://balkaninsight.com/2018/05/01/now-and-then-may-day-parade-04-22-2018/>

²⁶ <http://yugoslavian.blogspot.com/2009/05/labor-day-may-1st.html>

²⁷ <https://www.botasot.info/prishtina-kosova/694163/ja-si-u-festua-1-maji-ne-germi/>

²⁸ <https://www.botasot.info/prishtina-kosova/694163/ja-si-u-festua-1-maji-ne-germi/>

NJË MAJI, DITA NDËRKOMBËTARE E PUNËTORËVE

NJË MAJI NË DITËT E SOTME

Kjo festë sot festohet apo rikujtohet në 150 vende të botës. Në shumë shtete evropiane marshimet janë një traditë shumë e rëndësishme²⁹. Në Francë, punëtorët janë detyrimisht të obliguar, qoftë në sektorin publik apo në sektorin privat, që atë ditë të pushojnë nga puna. Ata nëpërmjet sindikatave, organizojnë parada dhe marshime në çdo qytet, me karakter paqësorë, ku traditë dhe simbol i këtyre parakalimeve është shpërndarja e lules së zambakut, familjarëve dhe miqëve të tyre³⁰.

Në shumicën e shteteve Evropiane dhe të Amerikës Veriore, ende për 1 Maj organizohen protestat e punëtorëve, edhe pse gjendja dhe kushtet mjedisore të punëtorëve në këto vende, janë në nivel të lartë, krahasuar me ato në Kosovë.

Duhet theksuar se në Kosovë, gjendja e punëtorit nuk është e tillë që 1 Maji të shënohet vetëm me manifestime, meqë problemet dhe çështjet me të cilat ballafaqohen punëtorët duhet të jenë në diskursin social. Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve është dita më e përshtatshme për të protestuar të gjitha problemet me të cilat përballen punëtorët. Në një vend si Kosova, ku ka një diskrepancë të gjerë mes shtresave, ku migrimi i fuqisë punëtore është në nivel shumë të lartë dhe ku siguria e punës nuk merret si çështje parësore, është e domosdoshme që punëtorët kosovarë të dalin për të protestuar.

Por viteve të fundit, vetëdijësimi i punëtorëve është më i lartë, dhe shoqëria demokratike e lejon këtë që edhe në Kosovë të organizohen protesta dhe marshime për 1 Maj, të cilat kryesisht organizohen nga sindikatat. Më 1 maj 2022, në sheshin Zahir Pajaziti, para ndërtesës së Qeverisë janë bërë dy protesta të punëtorëve, të cilat janë organizuar nga Federata Sindikale e Punëtorëve të Sektorit Privat dhe Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist³¹. Ndonëse ky është shembull i rëndësishëm, për të kuptuar se edhe në Kosovë po fillon të krijohet një vetëdijësim i punëtorëve për të drejtat e tyre, megjithatë mobilizimi i punëtorëve është i pamjaftueshëm në kuptim të organizimit të protestave, lidhur me kushtet e këqija dhe jo të favorshme të punës.

²⁹ https://en.wikipedia.org/wiki/International_Workers%27_Day

³⁰ <https://web.archive.org/web/20120503224311/http://service-public.fr/actualites/00790.html>

³¹ <https://shqip.com/1-maji-dita-e-punetoreve-dy-protesta-te-paralajmeruara-ne-prishtine/>